



UNIVERSITETI I SHKODRËS

“Luigj Gurakuqi”

Nr. 3244 Prot.

Shkodër, më 24 09 2016

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” do të shpallet konkursi për vend të lirë pune në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, në Departamentin e Romanistikës, në pozicionin lektor/e për lëndët : “Gjuhë italiane”, “Praktikë e gjuhës së shkruar I e II”, “Teknikë përkthimi”, “Teori e teknikë përkthimi”

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere :

- Të kenë kryer shkollën pasuniversitare me diplomë “Master Shkencor” ose gjatë studimeve universitare dhe pasuniversitare të ketë grumbulluar jo më pak se 300 kredite në fushën përkatëse me notë mesatare jo më të ulët se 9. Preferohet të ketë gradë “Doktor i shkencave”. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga MASH-i.
- Të kenë kryer arsimin e lartë në sistemin me kohë të plotë, në degën gjuhë italiane me notë mbi 8.5.
- Të kenë notën mesatare të lëndëve për të cilat konkurohet, jo më pak se 9.
- Të kenë dhënë provim universitar dhe/ose pasuniversitar lëndën për të cilën pretendojnë të jenë lektorë.
- Të kenë përvojë pune në profilin përkatës, preferohet jo më pak se dy vjet. Përparësi kanë kandidatët që kanë eksperiencë pune në Arsimin e Lartë apo kanë aktivitet botues.
- Të kenë njohuri të mira në një gjuhë të huaj perëndimore (preferohet anglisht) me notë jo më të ulët se 8.
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe kërkuese për realizimin e detyrave në Arsimin e Lartë.
- Shtetasit e huaj duhet të kenë leje pune dhe leje qëndrimi.

Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente :

1. Kërkesë me shkrim për aplikim.
2. Jetëshkrim (CV) me foto personale.
3. Dëshmi Doktorature, MND ose DND dhe e provimeve pasuniversitare (lista e notave) të njohura zyrtarisht. Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MASH-i.
4. Diplomë të Shkollës së Lartë ose fotokopje dhe lista e notave (të noterizuara).
5. Dy rekomandime nga mësimdhënës me tituj shkencorë në profilin për të cilin konkurohet.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, workshope etj.
9. Dëshmi e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) dhe mjekësore (librezë shëndeti).
10. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon dhe/ose vërtetim papunësie nga Zyra e Punës
11. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 8 të Rregullores së posaçme të Universitetit për Zënien dhe Ruajtjen e vendit të punës (për moslidhje farefisnore).
12. Çertifikatë familjare dhe dokument identifikimi vetjak (fotokopje pasaporte, letërnjoftimi ID).
13. Listë përmbledhëse e dokumenteve të dorëzuara nga konkurenti.
14. Çdo dokument tjetër që vërteton kërkesat e mësipërme.

Shënim:

- *Kontrata e punës do të jetë me afat 1 – vjeçar (vit akademik) me të drejtë rinovimi.*
- *Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Degës së Burimeve Njerëzore dokumentacionin e mësipërm deri më datë 15.10.2016, ora 12⁰⁰.*
- *Kandidatët që kualifikohen do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc deri më 20.10.2016.*
- *Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit dhe ora e saktë, t’i drejtoheni Departamentit të Romanistikës dhe Degës së Burimeve Njerëzore.*

